



VENDIM

Nr. 88, Datë 09.06.2016

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË ALBANIAN GREEN ENERGY” SHPK,
PËR SHTYRJEN E AFATEVE TE LICENSES NR. 63, SERIA
NPM08P, PER NDERTIM, INSTALIM, SHFRYTEZIMIN DHE
PRODHIMIN E ENERGJISE ELEKTRIKE NGA CENTRALE EOLIKE
(BLOK MOTORE-GJENERATORE TË USHQYER ME BIOMASE TË
LËNGSHME”, TE DHENE ME VENDIMIN E BORDIT TE ERE-S ME
NR. 89, DATE 06.08.2008, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, gërma “a” të Ligjit 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë të Elektrik”, Nenit 5 dhe 6, të “Rregullores për Procedurat e Heqjes së një Liçense”, neneve 16 pika 2 dhe 18 të Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE miratuar me vendimin nr 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar; pikës 1.2; 1.6 dhe 1.7 të kushteve të licensës nr. 63, seria NPM08P, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (Blok Motorë, Gjeneratorë të Ushqyer me Biomazë të Lëngshme), të dhënë me Vendimin e Bordit të Komisionereve ERE-s me Nr. 89, date 06.08.2008, i ndryshuar, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 09.06.2016, mbasi shqyrtoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE në licencën e shoqërisë “ALBANIAN GREEN ENERGY “ sh.p.k,

Konstatohet se:

- Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë ERE ka pranuar kërkesat e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k në lidhje me shtyrjen e afateve për realizimin e projektit duke përfshirë këtu edhe kolaudimin e veprës.
- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve me vendimet :
 - Vendimin e Bordit të Komisionereve Nr. 19, date 08.03.2010,
 - Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.92, date 06.09.2011,

- Vendimin e Bordit te Komisionerëve Nr. 138, datë 15.11.2013,
- Me shkresën me Nr. 03/15 Prot., date 03.04.2015, shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k, ka paraqitur një kërkesë tjetër për shtyrjen me 12 muaj të afateve te licensës se ndërtimit te dhënë me Vendimin e Bordit te Komisionerëve te ERE-s me nr. 89, datë 06.08.2008, i ndryshuar së fundmi me vendimin Nr. 138, date 15.11.2013.
- Mospërbushja e pikës 1 gërma “d” te vendimit nr. 89 datë 06.08.2008, i ndryshuar e bën licencën te pavlefshme.
- Kur nuk përmbushen kushtet thelbësore të licencës së dhënë, sipas ligjit NR. 43/2015, “për Sektorin e energjisë elektrike”, ERE me iniciativën e vetë mund të heqë licensën.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Rrezimin e kërkesës së shoqërisë “ALBANIAN GREEN ENERGY“ sh.p.k, për zgjatjen e afatit të licensës nr. 63, seria NPM08P, për ndërtim, instalim, shfrytëzimin të centrale elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (Bllok Motorë–Gjeneratorë të Ushqyer me Biomassë të Lëngshme), Shëngjin Lezhe, dhënë me Vendimin e Bordit te Komisionereve ERE-s me Nr. 89, date 06.08.2008.
2. Fillimin e procedurave për heqjen e licensës së shoqërisë “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k, nr. 63, seria NPM08P, dhënë me Vendimin e Bordit te Komisionereve ERE-s me Nr. 89, date 06.08.2008.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut të njoftojë shoqërinë për Vendimin e Bordit të të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI